

Ligj 67/2023 Datë 21.7.2023

**PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006,
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhet një ndryshim dhe disa shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 27, pika 3, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në shkronjën “a” fjala “bujqësore” hiqet.
2. Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1. Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është jo më shumë se 2 (dy) për qind e saj.”

Neni 2

Në nenin 36/1 shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Për subjektet që janë në proces aplikimi për t’u pajisur me leje ndërtimi për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është jo më shumë se 2 (dy) për qind e saj.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.7.2023.

Shpallur me dekretin nr.182, datë 31.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

Botuar ne F.Zyrtare 116/2023

Dale nga shtypi me 03.08.2023